



THIRRJE PËR POZICION TË LIRË PUNE

Pozicioni: Inspektor i navigimit ajror në Drejtorinë e Navigimit Ajror.

1. Cfarë po kërkojmë ne?

Autoriteti i Aviacionit Civil ka për qëllim rekrutimin e profesionistëve të fushës dhe përthithjen e ekspertëve në kuadër të rritjes së kapaciteteve.

Në këtë thirrje Autoriteti i Aviacionit Civil kërkon të rekrutojë profesionistë të fushës, me eksperiencë në industri, në fushën e navigimit dhe shërbimeve të trafikut ajror.

2. Detyrat e pozicionit të punës

- Përgatit mjetet e nevojshme për mbikëqyrjen efikase dhe efektive të sigurisë në operim sic janë Manuali i Inspektorëve, Listat e Kontrollit dhe Format e Auditit dhe i bëjnë ato lehtësisht të disponueshme në sektor.
- Asiston Drejtorin e DAN në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të autorizuar /çertifikuar Ofruesit e Shërbimeve të Dizenjimit të Procedurave të Fluturimit (PANS-OPS) në përputhje me rregulloret në fuqi standardet, procedurat e shkruara dhe direktivat e tjera përkatëse të nxjerra nga ACAA.
- Merr masat e nevojshme për ruajtjen e vazhdueshme të mbikëqyrjes së ofruesve të çertifikuar/autorizuar të dizenjimit të procedurave të fluturimit (PANS-OPS) në Shqipëri, në mënyrë që të sigurohet se ato respektojnë standardet e kërkuara të sigurisë të specifikuara nga ACAA.

3. Kërkesat e pozicionit të punës

- Edukimi: Diplomë Bachelor në Inxhinieri ose Shkenca Aviacioni.
- Gjuhë e huaj : Anglisht Niveli B2 (ose ekuivalente)
- 5 vjet eksperiencë pune në një agjenci në lidhje me mbikëqyrjen e sigurisë ose në Shërbimin e Kontrollit të Trafikut Ajror.

4. Dokumentacioni për dorëzim

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip të vënë në dispozicion nga Autoriteti.
- Diplomë Bachelor dhe/ose master e noterizuar.
- Fotokopje e librezës së punës.
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse.
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës (listë notash, vërtetim nga fakulteti), trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

- a) Aftësi shumë të mira komunikuese
- b) Aftësi organizative
- c) Aftësi për të punuar në grup

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për edukimin, përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

Vlerësimi maksimal për dokumentacionin është **40 pikë**

Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është **60 pikë**

Kandidatët që marrin të paktën 60 pikë në vlerësimin e përgjithshëm renditen te lista e pritjes

SHPALLJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, (vlerësimi i dokumentacionit dhe intervistës me gojë) Njësia e Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil do të shpallë fituesit në faqen e tij të internetit. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit. Afati i ankimit është **5 ditë** nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar.

Nëse mendoni se plotësoni kriteret e mësipërme Autoriteti i Aviacionit Civil ju fton të aplikoni në adresën zyrtare [rekrutime@caa.gov.al/](mailto:rekrutime@caa.gov.al)

Vetëm aplikantët të cilët kanë përbushur kriteret e përcaktuara në shpallje do të njoftohen për intervistë.